

Planprogrami mësimor i lëndës – syllabusi: Etika e biznesit

| | |
|----------------------------------|---|
| Të dhëna bazike të lëndës | |
| Njësia akademike: | FAKULTETI EKONOMIK |
| Titulli i lëndës: | Etika në biznes |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti III, semestri 6 |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 5 |
| Koha / lokacioni: | UKZ |
| Mësimdhënësi i lëndës: | |
| Detajet kontaktuese: | |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Etika e biznesit, falë konkurrencës së ashpër në treg, ku globalizimi përfshinë cdo pore të jetës afariste, paraqitet si imperativ afarist në zhvillimin e biznesit sipas parimeve të ekonomisë së tregut, bazuar në etikë dhe moral afarist.</p> <p>Viteve të fundit, jemi dëshmitarë të një gjallërimi shumë të madh dhe interesi të shtuar për trajtim të etikës biznesore, që duhet të përkrahë bizneset, qeveritë dhe institucionet arsimore në cdo vend. Andaj edhe nevoja për të mësuar-trajtuar etikën në biznes, përfshihen në kurikulat e cdo institucioni (shkolle) të biznesit modern.</p> <p>Studentët marrin njohuritë e domosdoshme që i ndihmon ata të kuptojnë jo vetëm rëndësinë e sigurimit të etikës së biznesit, por edhe të krijimit të mekanizmave mbrojtës nga bizneset joformale të cilat zhvillojnë afarizmin në baze të parimeve jo të shëndosha, joetike. Do të jenë studentët ata që do ta fillojnë punën si menaxherë të rinj në organizata të ndryshme, në sektorin privat dhe atë publik, prodhimi apo shërbimi, të cilët me njohuritë e marra në fushën e menaxhimit të biznesit në baze të parimeve etike dhe të fair play-te, do të nxisin ecjen përpara të organizatës në udhëtimin e sigurt drejt cilësisë.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Lënda ETIKA E BIZNESIT, është dizajnuar që t'i përgaditë studentët me konceptet bazë në fushën e menaxhimit të biznesit sipas parimeve të etikës biznesore. Objekt studimi do të jenë parimet etike të menaxhimit të biznesit, të cilat ndërmerret duhet që ti zbatojnë, nëse dojnë që të përshtaten në konkurrencën gjithnjë e më të ashpër në tregun global.</p> <p>Objektivat e lëndës janë të specifikuar në vijim: -Përgaditja e studentëve mbi principet bazë dhe metodat që e shoqërojnë menaxhimin e biznesit sipas parimeve etike,</p> |

| | <p>-T'u tregohet studentëve se si këto principe dhe metoda vendosen me efektivitet në organizata të ndryshme, Ekonomia kosovare ka nevojë për specialistët nga fusha e menaxhimit të binzeseve bazuar ne parime etike, në mënyrë që principet themelore dhe metodat e menaxhimit të cilësisë, të aplikohen me sukses në organizatat tona. Aq më tepër si vend në zhvillim, kemi nevojë për një hapërim më të shpejtuar, në mënyrë që menaxherët rinj, të suksesshëm, te jenë gjenerues te ndryshimeve pozitive në të gjithë sektorët e zhvillimit.</p> | | |
|--|--|------------------|------------------|
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Në fund të këtij kursi studentët do të jenë kompetentë: -Studentët të jetë në gjendje të kuptojnë se cka paraqet Etika ne biznes, cilat janë parimet bazë të funksionimit, cilat janë instrumentet e menaxhimit etik në organizatë, si bëhet vlersimi i etikes në organizatë, etj. -Studentët të ketë njohuri dhe të aftësi të mjaftueshme që të përdorë njohuritë e fituara praktikisht në organizatë- firmë. -Studentët të ketë kompetencë për çështjet e implemetimit të parimeve etike në organizatën konkrete, pasi që ata tashmë e kan të qartë se cilës tratimi i etikes ne biznes, nuk është dëshirë, por imperativ afarist për fatin e organizatës-firmës.</p> | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | / | / | / |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 5 | 10 |
| Ushtrime në teren | / | / | / |
| Kollokfiume,seminare | 2 | 3 | 6 |
| Detyra të shtëpisë | / | / | / |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 37 | 1 | 37 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | / | / | / |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 3 | 6 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 2 | 3 | 6 |
| Totali | | | 125 |

| | |
|---------------------------------------|--|
| Metodologjia e mësimëdhënies: | Mbarëvajtja e mësimimit sipas plan-programit do të jetë si në vijim: Ligjërata do të mbahen nëpërmjet prezantimeve me MS Power Point, Punimet Seminarike duhet të punohet nga studentët në MS Word si dhe prezantimi i punimeve në MS Power Point ku do të bëhet vlerësimi sipas strukturës për vlerësimin e studentëve. Ligjëratat janë të obligueshme. |
| Metodat e vlerësimit: | Metoda e vlerësimit është: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pjesëmarja në ligjërata 12% ▪ Kollokfiumi i parë 20% ▪ Kollukfiumi i dytë 20% ▪ Seminari/Detyrë kursi 13% ▪ Provimi përfundimtar 35% |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | 1. Hysen Cela: "Etika e biznesit" 2012, Tirane, |
| Literatura shtesë: | 1. William Shaw: "Business Ethics", A Textbook with Cases, 2010 2. Dr Ymer Havolli: "Etika e biznesit", Prishtine, 2009 |
| Plani i dizajnuar i mësimimit: | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | KONCEPTI I ETIKES SE BIZNESIT |
| Java e dytë: | KONFLIKTET NË BIZNES DHE KONFLIKTETE E INTERESAVE |
| Java e tretë: | NDERSHMERIA DHE PAANESIA |
| Java e katërt: | PJESËMARRËSIT NË FUNKSIONIMIN E BIZNESIT DHE TË ÇËSHTJEVE ETIKE |
| Java e pestë: | RESPEKTI, PËRGJEGJËSIA DHE REZULTATET |
| Java e gjashtë: | NORMAT UNIVERZALE , LIGJI, RREGULLAT DHE PROCEDURAT |
| Java e shtatë: | VLERAT, NDËRGJEGJJA, PREMTIMET |
| Java e tetë: | KOLOKUIUMI I PARE |
| Java e nëntë: | BIZNESI, ETIKA MENAXHERIALE DHE PROFITI, |
| Java e dhjetë: | PARIMET E PERGJITSHME ETIKE NE BIZNES |
| Java e njëmbëdhjetë: | TREGU DHE ETIKA |
| Java e dymbëdhjetë: | MARRJA E VENDIMEVE ETIKE NE BIZNES |
| Java e trembëdhjetë: | KODI I ETIKES |
| Java e katërbëdhjetë: | RASTE STUDIMI |
| Java e pesëmbëdhjetë: | PROVIMI FINAL |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studentët janë të detyruar të përmbushin të gjitha politikat dhe rregullat e sjelljes në bazë të Statutit të Fakultetit dhe Universitetit.
- Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në ndonjë aktivitet arsimor.
- Gjatë orëve të mësimi nuk është e lejuar prishjen e qetësisë dhe përdorimin e mjeteve të komunikimit.
- Nuk lejohet mbërritjes me vonesë ose largimin e kohës pa arsye.